



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1839/Prot.

Tiranë, 29.6.2020

Lënda: 2 Mbi shkresën tuaj nr.3447/1 datë 25.06.2020

Drejtuar: Ministrin të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Znj.Besa Shahini

Pwr dijani: Kryeministrin të Republikës së Shqipërisë

Z. Edi Rama

E nderuara zonja Ministre,

Së pari dua të theksoj faktin se më vjen mirë, që më në fund, keni shprehur një qëndrim tuajin, në cilësinë e Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për një çështje kaq të rëndësishme dhe po kaq delikate, megjithëse ju kam bërë me dije dhe ju kam informuar hollësisht për këtë çështje, duke kërkuar ndërhyrjen tuaj, dhe për më tepër, ju kam paraqitur edhe zgjidhjen për këtë problematikë, qysh me shkresën nr.5371/4 datë 19.12.2019, të cilën ju në fakt nuk e përmendni fare në shkresën tuaj nr.3447/1 datë 25.06.2020.

Zgjidhje të ligjshme të kësaj problematike, ju kam paraqitur edhe në shkresën nr.1839 datë 22.06.2020, të cilën, siç duket nuk e keni marrë aspak parasysh, duke treguar qartë se jo vetëm keni qenë në dijani të gjithë kësaj problematike, por edhe që jeni palë në këtë paligjshmëri.

Edhe në këtë rast, mesa duket, jeni përgjigjur, për arsye të shkresës së dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, të cilën ju e citoni në shkresën tuaj.

Në fakt, me shkresën tuaj nr.3447/1 datë 25.06.2020, jam njohur nga rrjetet sociale, qysh në mbasditen e datës 25 qershor 2020, sepse në protokollin e institucionit të Rektoratit të UT, kjo shkresë, ka mbërritur dhe është protokolluar në datën 26 qershor 2020.

Kjo nuk është as etike dhe as profesionale, për më tepër, të bën të kuptosh edhe shumë gjëra të tjera.

Megjithatë, le të analizojmë pak paragrafët e shkresës tuaj, përmbajtjen e tyre, si dhe “përfundimin” që keni arritur ju zonja Ministre në lidhje me këtë çështje.

Kështu, që në krye të shkresës, ju flisni për “parimin e autonomisë”, që kanë institucionet e arsimit të lartë, që sigurisht është një nga parimet kryesore që duhet të respektohet dhe të zbatohet në një institucion të tillë.

Më bën përshtypje fakti se, po në emër të këtij parimi, jeni munduar të “kapërceni” apo të justifikoheni edhe në raste të tjera, ku, pas shumë e shumë kërkesash zyrtare, për çështje dhe problematika të ndryshme që ju kam paraqitur (për të cilat keni ju kompetencë), kam kërkuar ndërhyrjen dhe qëndrimin tuaj për rastin në fjalë.

Por “autonomia” e institucionit të arsimit të lartë, është e rregulluar me një kuadër ligjor të caktuar, i detyrueshëm për t’u zbatuar nga të gjithë.

Kjo do të thotë që askush dhe për asnjë arsye, nuk mund të mos zbatojë kuadër ligjor të caktuar që rregullon funksionimin e institucionit në tërësi, nga çdo autoritet, organ drejtues, apo strukturë në veçanti, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Ministria përgjegjëse për arsimin, në zbatim të ligjit të arsimit të lartë 80/2015, në ushtrim të kompetencave dhe përgjegjësive që ka, sigurisht që ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e menjëhershme të kësaj problematike, por “harron” se ka **edhe detyrën për të kontrolluar pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

Për ju zonja Ministre, respektimi apo jo i procedurave për lëshimin e numrave të matrikullimit për studentët nga autoritetet drejtuese të UT, “konsiderohet se është çështje e brendshme” dhe harroni (ose bëni sikur) se në këtë mënyrë, **jeni duke shkelur, nenin 76, pika 6, të ligjit të arsimit të lartë 80/2015 dhe Udhëzimin nr.15 datë 19.05.2017 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kreu VI, pika 1.**

Pra, për ju zonja Ministre, nuk ka rëndësi fare që Dekani i Fakultetit të Ekonomisë i UT, ka shkelur ligjin; për ju nuk ka rëndësi as fakti që edhe Drejtoresha e Qendrës të Shërbimeve Arsimore, që është institucion në varësinë tuaj direkte, ka shkelur ligjin.

Pra e thënë ndryshe, ministrit përgjegjës për arsimin, nuk i intereson aspak ligjshmëria e diplomave të studentëve, meqënëse “urdhëron” Rektorin e UT që t’i firmosi ato.

Ky është rast i paprecedentë në historinë e MASR.

Zonja Ministre,

Në cilësinë e Rektorit të UT, ju bëj me dije se qëndrimi im ndaj këtij problemi kaq të rëndësishëm, edhe pas shkresës tuaj të fundit, mbetet i njëjtë.

Për mua, zbatimi i ligjit mbetet një gjë e shenjtë, të cilën nuk e çënoj për asnjë arsye dhe për këtë arsye, nuk mund të jem pjesë e kësaj paligjshmërie.

Pasi kam ezauruar të gjitha rrugët institucionale dhe ligjore, pas një komunikimi të gjatë shkresor me drejtuesin e Fakultetit të Ekonomisë të UT dhe me drejtuesin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), në lidhje me këtë çështje, duke parë që situata vazhdonte të ishte e njëjtë, në muajin shkurt 2019 i jam drejtuar organeve kompetente, të cilët kanë regjistruar procedim penal....

Sa kohë që nga ana e drejtuesit të njësisë kryesore të Fakultetit të Ekonomisë të UT, z.Kule, nuk janë përcjellë listat përfundimtare të studentëve të regjistruar, me të dhënat e tyre për matricullim (detyrim ligjor ky, siç kanë vepruar të gjithë dekanët e tjerë të UT për gjithë këto vite), për vitin akademik 2017-2018, 2018-2019, e bën të pamundur lëshimin e këtyre diplomave nga Universiteti i Tiranës.

Kësisoj, këto kartona (jo diploma), nuk mund të nënshkruhen nga Rektori i Universitetit të Tiranës.

Në momentin kur në Rektoratin e UT do të përcillet nga dekani i Fakultetit të Ekonomisë i UT, lista përfundimtare e studentëve të regjistruar, me të dhënat e tyre për matricullim (për vitin akademik 2017-2018), Rektori do të veprojë në mënyrë të menjëhershme, me nënshkrimin e tyre.

Kjo është e vetmja mënyrë institucionale, e rregullt dhe ligjore, në zbatim të ligjit të arsimit të lartë 80/2015 dhe Udhëzimit përkatës, të nxjerrë nga vetë Ministri përgjegjës për arsimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

REKTORI
PROF. DR. MYNYR KONI

